



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Dhoma Civile
K/Sekretaria

Bulevardi "Gjergj Fishta" Tiranë

www.gjykatatirana.gov.al

Tiranë, më 30.05.2022

Lënda: Dërgim vendimi

QËNDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë vendimin me Nr.2231 Vendimi datë 26.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

K/SEKRETARE

Adela ÇINARI



REPUBLICA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE



Nr: 9881/4147 Regj. Themeltar
Dt. regjistrimi 17. 02. 2021

Nr: 2231 Vendimi
Dt. vendimi 26. 04. 2022

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqësore **Marena Panda** sot më datë **26. 04. 2022** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen civile me **Nr. 9881/4147 Regj. Themeltar** që i përket :

KERKUES :

† SHOQERIA “BPO Solutions” sh.p.k. me NIPT L418130051, me adrese Tirane, Lagjja Selite, Rezidenca Kodra e Diellit, Rruga e Trendafilave, Ndertesa Nr. 45, me perfaqesues ligjor z. Eri Gegolli, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi dt. 03. 09. 2020 nga *av. Xhoi Skenderasi*.

OBJEKTI :

Likujdimit te thjeshtezuar te shoqerise “BPO Solutions” shpk permes procedures se likujdimit te thjeshtezuar dhe ç’regjistrimin e saj prane QKB-se.

BAZA LIGJORE :

Neni 204 pika 1, 205 e Ligjit Nr. 9901 dt. 14. 04. 2008 « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare », i ndryshuar. Neni 49 i ligjit Nr. 9723 dt. 03. 05. 2007 i ndryshuar i QKB-se.

Gjykata pasi dëgjo pretendimet e perfaqesueses se kerkuesit, e cila kerkoi : *Pranimin e kërkesës sipas objektit te saj*, pasi administroi provat shkresore dhe shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,

VEREN :

Se, shoqeria “BPO Solutions” sh.p.k. nepermjet perfaqesueses se saj me autorizim i eshte drejtuar gjykates dhe ka kerkuar mbylljen e procedures se likujdimit te thjeshtezuar te shoqerise.

Në bazë të Neneve 36, 41, 59, 334 të K. Pr. Civile, gjykata pasi shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kompetencen e saj lendore e tokesore, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykate eshte kompetente nga pikepamja lendore e tokesore.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi e provuar se :

Shoqëria "BPO Solutions" sh.p.k. është shoqëri tregtare e së drejtës tregtare shqiptare e krijuar me aktin themelues të datës 02. 06. 2014 me seli të saj në Tiranë, Lagjia Selite, Rezidenca Kodra e Diellit, Rrugë Trendafilave, Ndertesa Nr. 45 dhe me pas është regjistruar në Q. K. B. në dt. 13. 06. 2014 me objekt të veprimtarisë së saj : operimi dhe menaxhimi i shërbimeve, call center hyres dhe dales. Aktivitet në fushën e ofrimit të shërbimeve të ndryshme online... Ortak i vetëm i kësaj shoqërie është shoqëria "SELCOM" shpk. Kapitali themelues i shoqërisë është 100, 000 lek.

Ka rezultuar se gjatë veprimtarisë së saj kjo shoqëri nuk ka patur aktivitet të madh përgjatë kohegjatjes së veprimtarisë së saj dhe për më tepër jo fitimprures. Nisur nga mungesa e veprimtarisë tregtare për të cilën kjo shoqëri është krijuar, shoqëria "BPO Solutions", ortaku i saj, shoqëria "Selcom" shpk ka ndermarre iniciativën për të filluar procedurën ligjore për likuidimin e thjeshtezuar të shoqërisë. Për këtë arsye në dt. 10. 02. 2021 me vendimin respektiv të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "BPO Solutions" sh.p.k. në zbatim të Nenit 204/1 të Ligjit Nr. 9901 dt. 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ortaku (shoqëria Selcom shpk) ka vendosur: *1. Prishjen e shoqërisë "BPO Solutions" shpk për arsye se nuk ushtron aktivitet tregtar prej një kohe të gjatë. 2. Likuidimin e thjeshtezuar të shoqërisë "BPO Solutions" shpk. 3. Emerimin e z. Eri Gegolli si administratori i ri i shoqërisë me afat 1 (një) vjeçar. Autorizohet administratori i ri për të ndjekur procedurën e depozitimit të këtij vendimi.*

Në vijimësi në zbatim të Nenit 204 të ligjit, në dt. 08. 03. 2019 përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë i ka dërguar njoftim Q. K. B-së për vendimmarrjen e saj për prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurës së likuidimit të thjeshtezuar (çështja CN-659207-02-21 dt. 15. 02. 2021). Pas këtij veprimi shoqëria nëpërmjet përfaqësueses së saj me autorizim të leshuar nga administratori i shoqërisë z. Eri Gegolli ka iniciuar me pas procedurën ligjore për mbylljen e këtij likuidimi të thjeshtezuar dhe ç' regjistrimin me pas të kësaj shoqërie nga Q. K. B-ja.

Neni i mesiperm si referencë i jep kompetencën të plotë gjyqësorë për të proceduar me perfundimin e këtij likuidimi të thjeshtezuar. Konkretisht ky nen percakton se : *1. Shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit. 2. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtezuar. 3. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtezuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra. 4. Paditë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data e çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.*

Në interpretim të Nenit të mesiperm, konstatohet se dy janë kushtet ligjore substanciale që duhet të plotësohen nga shoqëria për të vendosur gjykata me pas për perfundimin e procedurës së thjeshtezuar të likuidimit, konkretisht a) *mospasja e detyrimeve ndaj kreditorëve dhe b) mospasja e detyrimeve ndaj punëmarrësve të shoqërisë.* Këto kushte duhet të qendrojnë në mënyrë kumulative (bashkarisht) që të provohet përmbushja e plote e tyre para gjyqësorit.

shija e shoqerise tregtare vijohet nga procesi i likujdimit, permes te cilit shlyhen te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve dhe ndahet teprica e likujdimit mes ortakeve apo aksionereve sipas raportit te pjesemarrjes se tyre ne kapitalin e shoqerise.

Ky veprim tregtar mund te realizohet permes procedurave ligjore te likujdimit te zakonshem ose likujdimit te thjeshtezuar. Likujdimi i thjeshtezuar perfaqeson nje procedure te thjeshte dhe te shpejte likujdimi, ne rastet kur shoqeria tregtare nuk ka detyrime ndaj te treteve dhe mes ortakeve/aksionereve nuk ekzistojne mosmarreveshje per procesin e likujdimit, ne ndryshim nga procedura e zakonshme, ne te cilen detyrimet e shumta te shoqerise ndaj kreditoreve apo dhe pretendimet e ortakeve/aksionereve mbi ndarjen e tepriceve se likujdimit kerkojne investimin ne kete proces te likujdimit te zgjedhur ne menyren e percaktuar ne ligji.

Rezultoi e provuar se nga ana e perfaqesuesit ligjor te shoqerise "BPO Solutions" sh.p.k. u paraqit nje deklarate noteriale Nr. 190 Rep. Nr. 69 Kol. dt. 10. 02. 2021 e ortakut te shoqerise (*e administruar si prove ne gjykim*) sipas se ciles nen pergjegjesine e tij ligjore deklaroi se: "*Deklaroj se te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet e shoqerise ne lidhje me kreditorët dhe punemarresit jane shlyer dhe shoqeria nuk ka asnje detyrim apo pergjegjesi te pashlyer ndaj paleve te treta*".

Po keshtu nepermjet vertetimeve respektive: Nr. 7618/1 Prot dt. 21. 04. 2022 te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, Nr. T05907984 dt. 08.04.2022 dhe Nr. T05907990 dt. 08.04.2022 te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve-Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane dhe Nr. 1312 Prot. dt. 20. 04. 2022 te Bashkise Tirane, Njesia Administrative Farke, provohet se kjo shoqeri nuk ka asnje detyrim aktual apo te akumuluar ndaj tyre.

Po keshtu provohet sipas vertetimeve respektive te sjella nga pala kerkuese dhe te marra nga Gjykata dhe Zyra e Permbarimit Shteteror se kjo shqetimi nuk ka procese penale, civile dhe ekzekutive te detyrueshme ndaj saj.

Ne kete menyre nga pala kerkuese u provuan te gjitha kerkesat ligjore per perfundimin e procedurave se likujdimit te thjeshtezuar per shoqerine "BPO Solutions" sh.p.k.

Me tej Neni 205 i ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar percakton se: "*Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura ne vijim te procedurës se likujdimit te thjeshtezuar administratori i shoqerise njofton QKB per perfundimin e likujdimit te thjeshtezuar dhe kerkon ç'regjistrimin e shoqerise ne perputhje me nenin 49 te ligjit Nr. 9723 dt. 03. 05. 2007 "Per QKR" i ndryshuar.*

Referuar dispozites se mesiperme ligjore ngarkohet administratori i shoqerise qe pas miratimit gjyqesisht te procedurave se likujdimit te thjeshtezuar te realizoje shperndarjen e aktiveve te mbetura, te njoftoje per perfundimin e likujdimit QKB-ne dhe me pas te paraqese kerkese per ç'regjistrimin e shoqerise prane QKB-se ne baze te ketij neni (49)

Neni 49 i Ligjit Nr. 9723 dt. 03. 05. 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" percakton se : "*Ç'regjistrimi në mënyrë vullnetare për personat juridikë, degët dhe zyrat përfaqësimit të shoqërive të huaja dhe për shoqëritë e thjeshta dhe për subjekte të tjera për të cilat ligji parashikon procedura likujdimi, kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim dhe depozitimit të akteve përkatëse, që vërtetojnë kryerjen dhe mbylljen e procedurave të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi. Ç'regjistrimi nuk kryhet nëse aktet e ndërmjetme të procesit të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi, nuk janë njoftuar dhe depozituar pranë regjistrimit tregtar. Këto akte depozitohen në formën e kërkuar nga ky ligj dhe/ose nga dispozita të tjera ligjore në fuqi.*

Ne vijim Neni 51 i Ligjit Nr. 9723 dt. 03. 05. 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" percakton se: "*Ç'regjistrimi nga regjistri tregtar kryhet në bazë të një vendimi gjyqësor të*

paankimueshëm apo të vendimit përfundimtar të një autoriteti tjetër publik, kur parashikohet nga ligje të posaçme, në rastet e pavlefshmërisë së personave juridikë pas mbylljes së likuidimit në rrugë gjyqësore, të falimentimit apo në raste të tjera, të parashikuara nga ligji. QKR-ja çregjistron kryesisht subjektin brenda 1 dite nga data e marrjes së vendimit përkatës”.

Legjislatori ndryshe nga procedura e gjate e likuidimit të shoqerive, në Titullin II të ligjit, Nenet 204-205 të tij ka parashikuar këto procedure të veçante të likuidimit të pershpjtuar me qëllim për tu ardhur në ndihmë shoqerive të cilat rezultojnë në aktivitetin e tyre jo fitimprurëse.

Sa me sipër duke qenë se ligji ka përcaktuar si organ kompetent që ligjëron përfundimisht këto procedure, gjykatën, atëherë para saj u provua se nga ana e shoqerisë “BPO Solutions” sh.p.k., janë respektuar të gjitha procedurat ligjore të kërkuara për fillimin dhe përfundimin e procedurës së likuidimit të thjeshtuar. Në këtë mënyrë kjo kërkesë për përfundimin e kësaj procedure për gjykatën është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në Nenin 204 të Ligjit Nr. 9901 dt. 14. 04. 2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Nenin 49, 51 të Ligjit Nr. 9723 dt. 03. 05. 2007 “Per Qendren Kombetare të Regjistrimit” dhe Nenet 126-306 e vijues, 444 të K. Pr. Civile.

VENDOSI :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Miratimin e procedurës së likuidimit të thjeshtuar për shoqerine “BPO Solutions” sh.p.k. me NIPT L41813005I, me adresë Tiranë, Lagjja Selite, Rezidenca Kodra e Diellit, Rruga e Trendafilave, Ndertesa Nr. 45, me përfaqësues ligjor z. Eri Gegolli.
3. Një kopje e këtij vendimi pasi të marrë formë të prerë t’i dërgohet Qendres Kombetare të Biznesit (Q.K.B.).
4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, pa kërkesë.
6. U shpall sot më 26. 04. 2022 në Tiranë.

Vendimi mori formë të prerë pasi
nuk u ankimua më dt 24/05/2022

Tiranë më dt 27/05/2022

SEKRETARE

MARENA PANDA

GJYQTAR

K / SEKRETARE
ADELA ÇINARI

ERVIN POLLOZHANI

TABELA E SHPENZIMEVE GJYQËSORE

Nr.	Shpenzime Gjyqësore	Pala që ka Parapaguar / Paguar Shpenzimin Gjyqësor			Sasi	Çmim	Vlerë
		Gjykata	Paditës	I Paditur			
1	Tarife Gjyqësore		200		1	200	200
2	Shpenzime për Njoftime		150		1	150	150
	Shuma						350